V E N D I M
Nr. 195, datë 20.3.1998

PËR PRIVATIZIMIN E NDËRMARRJEVE QË NUK MUND TË TRANSFORMOHEN

Në mbështetje të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", ndryshuar me ligjin nr.8159, datë 7.11.1996, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Objekti i këtij vendimi janë ndërmarrjet, të cilat sot për sot e kanë ndërprerë veprimtarinë ekonomike dhe nuk plotësojnë kriteret e transformimit në shoqëri tregtare, në zbatim të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëritë tregtare", ndryshuar me ligjin nr.8237, datë 1.9.1997 dhe ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

2. Lista e ndërmarrjeve me të dhënat përkatëse i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nga organet qendrore dhe pushteti lokal, sipas vartësisë administrative të ndërmarrjeve.Kjo listë publikohet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit

3. Format e privatizimit janë:

- shitja;
- shitja me rezervë;
- kontrata e enfiteozës;

4. Përzgjedhja e formës së privatizimit bëhet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, sipas propozimeve të bëra në ofertat parakualifikuese, duke i dhënë përparësi shitjes.

5. Për shitjen dhe shitjen me rezervë ngarkohet AKP-ja ta realizojë atë në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 20.3.1998 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe procedura e shitjes".

6. Kontrata e enfiteozës lidhet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit sipas dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

7. Vlerësimi i kapitalit të ndërmarrjeve dhe dokumentacioni përkatës për privatizim përgatiten sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 20.3.1998 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohen, si dhe procedura e shitjes". Afatet e vlerësimit përcaktohen me urdhër të Ministrit. Për drejtuesit që pengojnë procesin e privatizimit, të merren masa disiplinore sipas nenit 7 të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqërie tregtare", ndryshuar me ligjin nr. 8237, datë 1.9.1997.

8. Ndryshimet në kapitalet e ndërmarrjeve për nevojë të ristrukturimit bëhen me urdhër të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano